



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 622/5 prot.

Tiranë, më 26.12.2023

VENDIM

Nr. 1041, Datë 26.12.2023

“PËR ZGJEDHJEN E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË AUTORITETIT TË KONKURENCËS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Zgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.

Baza Ligjore: Neni 27, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; VKM nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, Kreu IX, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe Informacion mbi procedurën e konkurrimit për pozicionin: Sekretar i Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit (Njësia Përgjegjëse),

VËREN SE :

Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, me shkresën nr. 569 prot., datë 11.10.2023 ka bërë shpalljen për një vend të lirë pune në pozicionin Sekretar i Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, i cili është publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND”, i

ndryshuar, pas vlerësimit paraprak të dokumenteve të kandidatëve, të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, kandidati që ka plotësuar kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për të vazhduar procedurën e pranimit në kategorinë e lartë drejtuese ka rezultuar Z. Endi Çekani.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 6, datë 19.09.2014 “Për procesin e rekrutimit dhe emërimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND”, nga konkurrimi i realizuar në datën 15.12.2023 nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatit, testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, nëpërmjet procedurës së pranimit në kategorinë e lartë drejtuese për pozicionin Sekretar i Përgjithshëm, është shpallur fitues Z. Endi Çekani.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 27, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe VKM nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, Kreu IX, pika 2,

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e Z. Endi Çekani, në pozicionin Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës.
2. Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare do të fillojnë në datë 4 janar 2024.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATJA


Zv/Kryetar


Rezana KONOMI


Anëtar

Adriana BERBERI


Anëtar

Durim KRAJA


Anëtar


Denar BIBA
Kryetar